VENDIM
Nr. 387, datë 28.5.2026

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "FOS SOLAR" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "FOS SOLAR" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "FOS SOLAR" sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: M41713005G;

c) Tipi i centralit: Fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 40 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqëria "FOS SOLAR" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë "FOS SOLAR" sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin

e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "FOS SOLAR" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
CENTRALI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "FOS SOLAR" SHPK

KRGJSH	X	Y
1	451950.883	4511593.069
2	452214.827	4511811.949
3	452332.203	4511666.861
4	452073.561	4511443.251
5	452078.229	4511437.734
6	452303.318	4511628.185
7	452517.036	4511804.775
8	452636.21	4511657.336
9	452426.349	4511477.854
10	452200.663	4511288.239
11	452206.633	4511280.165
12	452440.421	4511653.08
13	452650.193	4511653.08
14	452770.981	4511505.57
15	452651.675	4511331.024
16	452327.11	4511133.345
17	452320.391	4511116.751
18	452097.197	4510920.328
19	451976.705	4510742.302
20	451988.125	4510600.673
21	452211.048	4510786.856

22	452435.655	4510979.743



NR	X	Y
1	451950.883	4511592.069
2	452214.827	4511811.949
3	452332.203	4511666.861
4	452073.561	4511443.251
5	452078.229	4511437.734
6	452303.318	4511628.185
7	452517.036	4511804.775
8	452636.21	4511657.336
9	452426.349	4511477.854
10	452200.663	4511288.239
11	452206.633	4511280.165
12	452440.421	4511475.872
13	452650.193	4511653.08
14	452770.981	4511505.57
15	452561.675	4511331.024
16	452327.11	4511133.343
17	452320.391	4511116.751
18	452097.197	4510920.328
19	451876.705	4510742.302
20	451988.125	4510600.673
21	452211.048	4510786.856
22	452435.655	4510979.743